

V E N D I M
Nr.158, datë 11.4.1994

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL

Në zbatim të ligjit nr.7807, datë 19.3.1994 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1994", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat që i takojnë pushtetit lokal sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave të ish-pronarëve" dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 "Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme", vendimit nr.386, datë 26.7.1993 "Për dhënien me qira të objekteve shtetërore", vendimit nr.478, datë 7.11.1992" Për krijimin, evidencimin dhe administrimin e të ardhurave që realizojnë inistucionet buxhetore nga shërbimet që ato u afrojnë të tretëve" si dhe të ardhurat nga taksat lokale dhe nga objektet ose aktivitetet e tjera që i janë lënë në administrim pushtetit lokal do të përdoren për këto qëllime:

a) Për përballimin e të gjitha pagesave që lindin në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve lokale (pagesa e likuidatorëve kur ndërmarrja nuk ka asnjë mundësi financiare, shpenzimet për konservim kur ndërmarrja është kalur në bordin e privatizimit dhe pret privatizimin). Në këto raste organet e pushtetit lokal përcaktojnë organikën e këtyre ndërmarrjeve.

b) Për të mbuluar të gjitha shpenzimet direkte që lidhin me objektin për të cilin mblidhen taksat lokale.

c) Për përballimin e të gjitha pagesave që rrjedhin nga procesi i kthimit të pronave të ish-pronarëve për të cilat jepet shpërblim me para në dorë sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave të ish-pronarëve".

ç) Për përballimin e të gjithave shpenzimeve materiale dhe të tjera që lidhen me punën e komisionit të kthimit të pronave.

d) Për përballimin e të gjitha shpenzimeve jashtë buxhetit të kushtëzuar për aktivitetet dhe objektet që i janë lënë në administrim pushtetit lokal.

dh) Pasi të shlyhen detyrimet e mësipërme, pjesa e mbetur do të përdoret si më poshtë:

- Për shpenzime administrative të aparateve 3O për qind të shumës së akorduar në planin fillestar të buxhetit për këtë organ të pushtetit lokal.

- Për përballimin e shpenzimeve që rrjedhim nga vendime gjyqësore.

- Pjesa që mbetet, për investime.

2. Taksat lokale që mblidhen nga organet e pushtetit lokal do të përdoren nga vetë organet që i mbledhin. Taksat e tjera lokale si dhe të ardhurat e realizuara nga privatizimi i pronës shtetërore do të ndahen proporcionalisht me fondet buxhetore të akorduara nga Kuvendi Popullor ndërmjet 3 niveleve të pushtetit lokal rretheve, bashkive dhe komunave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi